



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1579/5 prot.

Datë 25.08.2023

V E N D I M

Nr. 813/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.08.2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekti: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Malbertex” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-72698-06-15-2023, me objekt: “Blerje uniforma për Policinë Bashkiake” me fond limit 6,833,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 30.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Ankimues: “Malbertex” SHPK
Rruga Siri Kodra Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Durrës
Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave

*Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së
Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë
gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet tre anëtarët , në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës në autoritet kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16-06-2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar ”, me Nr. REF-72698-06-15-2023, me objekt: “Blerje uniforma për Policinë Bashkiake” me fond limit 6,833,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 30.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës

II.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 30.06.2023 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

“Malbertx” SHPK	5607900	lekë	skualifikuar
“Gentian Sadiku” Pf	6242200	lekë	skualifikuar
“Bledi Loci ” p.f	6574800	lekë	skualifikuar

Operatori ekonomik ankimues “Malbertex” SHPK rezulton i skualifikuar me arsyetimin:

“Nuk permbush piken 2.3.6 te Kapacitetit Teknik, te ndryshuar me Shtojcen e dates 22.06.2023, ku citohet se “OE ofertues duhet te paraqese certifikate konformiteti produkti per artikujt: Xhup sipas standardeve SSH/ EN 343:2019; SSH/ EN ISO 20471:2013; SSH/ EN ISO 13688:2013; SSH/ EN 342:2017”, pasi pas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur, konstatohet se operatori ekonomik ofertues nuk ka paraqitur certifikate konformiteti te vlefshme, sipas kerkesave te AK ne dokumentet e tenderit.

II.3. Në datën 03.07.2023 nga verifikimi në sistemin elektronik rezulton, se është publikuar në SPE njoftimi i anulimit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.4. Në datën 06.07.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1579 protokoli e operatorit ekonomik “Malbertex” SHPK lidhur me skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr.1579/2 datë 07.07.2023 u publikuan arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues. Gjithashtu, nga informacioni i autoritetit kontraktor rezulton se ankesa e operatorit ekonomik “Malbertex” SHPK është dorëzuar në autoritet kontraktor me datë 06.07.2023.

II.5. Me shkresën nr. 1269/20 prot., datë 17.07..2023, protokolluar me tonën me nr. 1579/3 prot., datë19.07.2023 , është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni lidhur me trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues “Malbertex” SHPK në të cilin konstatohet, se autoriteti kontraktor nuk e ka pranuar ankesën.

II.7. Nga verifikimet e kryera, rezulton, se janë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumente nga subjekte të interesuara, lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në formë shkresore dhe në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Malbertex” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit me arsyen se:

Nuk permbush piken 2.3.6 te Kapacitetit Teknik, te ndryshuar me Shtojcen e dates 22.06.2023, ku citohet se “OE ofertues duhet te paraqese certifikate konformiteti produkti per artikujt: Xhup sipas standardeve SSH/ EN 343:2019; SSH/ EN ISO 20471:2013; SSH/ EN ISO 13688:2013; SSH/ EN 342:2017”, pasi pas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur, konstatohet se operatori ekonomik ofertues nuk ka paraqitur certifikate konformiteti te vlefshme, sipas kerkesave te AK ne dokumentet e tenderit.” KPP vëren se,

III.1.1. Në shtojcën e publikuar me date 22.06.2023 me ndryshimet, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

ISHTE:

2.3.6 OE ofertues duhet te paraqese certifikatë konformiteti produkti per artikujt:

- Xhup sipas standardeve
- EN 343:2003+A1:2007;
- EN ISO 20471:2013 ;
- EN ISO 13688:2013 EN 342:2017

ne menyre qe te veretohet cilesia e tyre me specifikimet teknike te kerkuara.

BËHET:

1.3.6 OE ofertues duhet te paraqese certifikatë konformiteti produkti per artikujt: Xhup sipas standardeve

- SSH/ EN 343:2019;
- SSH/ EN ISO 20471:2013 ;
- SSH/ EN ISO 13688:2013
- SSH/ EN 342:2017

III.1.2. Në përmbushje të kriterit më sipër operatori ekonomik ankimues ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin si më poshtë:

-Deklarate Konformiteti EU, e perkthyer dhe e noterizuar me nr rep 3061 datë 22.06.2023

Pajisjet mbrojtëse personale kat. 2:

SEFTON - 0301007379

2. Emri dhe adresa e prodhuesit:

CERVA GROUP a.s.

Prumyslova 483, 252 61 Jenec, Republika eke

3. Kjo deklarate konformiteti leshohet nën përgjegjësinë e vetme të prodhuesit:

CERVA GROUP a.s.

4. Objekti i deklarates:

Xhup SEFTON HV

5. Objekti i deklarates se pershkruar ne piken 4 Eshte ne perputhje me legjislacionin perkates te harmonizimit te Bashkimit:

Rregullorja (BE) 2016/425 e Parlamentit dhe e Keshillit

6. Standardet e harmonizuara ne lidhje me te cilat deklarohet konformiteti

EN ISO 20471:2013+A1:2016 (Klasa: 3)

EN ISO 13688:2013

EN 342:2017 (0.303(B)3ËP)

EN 343:2019 (31X)

7. Organi akreditues 0493, CENTEXBEL GENT, Technologiepark 7, BE-9052 Zëijnaarde/
Belgike ka kryer ekzaminimin e llojit EU (Moduli B) dhe ka leshuar certifikaten e
ekzaminimit të tipit 420/2021/1156 me 11 nentor 2021

Nënshkruar për dhe ne emer te

Jenec 8 nentor 2021

CERVA GROUP a.s.

III.1.3. Në shtojcën e publikuar “preventiv” është parashikuar si më poshtë:

Preventiv përmbledhës

Lista e Uniformave dhe paisjeve për Policinë Bashkiake

Nr	Artikulli	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Kostume	copë	38		
2	Xhup	copë	38		
3	Pantallona verore	copë	160		
4	Pantallona dimerore	copë	160		
5	Kemishë me mëngë të shkurtra	copë	160		
6	Këmishë me mëngë të gjata	copë	160		
7	Kollare	copë	80		
8	Kapele verore	copë	160		
9	Emblema krahu	copë	160		
10	Këpucë dimerore	copë	80		
11	Këpucë verore	copë	80		
12	Pulovra	copë	80		
13	Bluza	copë	160		
14	Rrip operacional	copë	38		
15	Shirit Sinjalizues	copë	25		
16	Kostum ceremonial	copë	10		
17	Athlete Uniforme	copë	10		
18	Elektik i thjeshte	copë	10		
19	Jelek fosforeshent profesional	copë	80		
20	Xhiboks forforeshent operacional	copë	60		
21	Numer identifikimi	copë	160		
22	Pantallona te shkurtra	copë	20		

23	Emblema kapele	copë	160		
24	Pranga	copë	40		
25	Shkopinj Gome	copë	40		
26	Dryna per bllokuse	copë	60		
27	Tabela	copë	80		
28	Bilbila	copë	80		
	Totali				
	TVSH 20%				
	TOTALI me TVSH				

III.1.4 Ne shtojcën e publikuar ne DST , autoriteti kontrkaotr ka publikuar “Specifikimet teknike” si me poshte:

SPECIFIKIME TEKNIKE

I.KOSTUM TERITALI, BLU

Materialet qe do te perdoren per prodhimin e kostumeve:

- Stof ngjyre blu i erret, cilesi e pare me perzjerje 45 % lesh dhe 55%poliester ($\pm 3\%$);
- Numri i fillit: a) Ne baze = 40/2, 42/2; b) Ne ind = 40/2, 42/2;
- Dendesia ne 10 cm: a)Nebaze =310 ± 10 ; b) Ne ind = 260 ± 10 ;
- Qendrueshmeria kg: a) Ne baze = 90-6; b) Ne ind = 80-6;
- Astar mendafshi importi(blu e erret ose e zeze) 100% poliester.
- Merle (material ngjites special dhe i pershtatshem per pjesen e gjoksit),100% poliester.
- Frazeline (material ngjites per xhaketen dhe pantallonat).
- Astar xhepi, tekstil 100% viskoz.
- Vata (jo pambuku) te posapme per kostum burri.
- Penj qepje blu 80/2, qepje industriale 100% poliester.
- Thurje = sarzh.
- Kopsa te vogela e te medha, ngjyre argjendi. Fusha e kopses te jete e paster, pa relieve e konfiguracione te ndryshme brenda.
- Kanavace importi, 100% lesh.
- Stof leshi me ngjyre te pershtateshme per pjesen e nenteshme te jakes se xhaketes. - Viera e qendrueshmerise se ngjyrave nota 4-5.
- Pesha per m2 = 290 ± 10 gr.
- Xhaketa : Monopet, me kater kopsa te medha para, me prerje hark nga shpatulla deri ne fund, me carje prapa. Me dy xhepa pllake poshte (180 x 210 mm) me kapak dhe larte (140 x 160 mm). Xhepat kane muzhike vertikal. Mbi xhepin e djathte qepet velkrof per numurin personal dhe ne krahun e majte, poshte kokes se supit qepet shiriti hark ku shkruhet me qendisje me penj te bardhe ” POLICIA BASHKIAKE ” dhe nen te sterna e Bashkise. Spaletat me permasa: 50 x 130 mm, me fileto te kuqe anash, mberthehen me kopse metalike ngjyre argjendi. Dy xhepa te brendshem qe mberthehen me kopse ebaniti ngjyre e zeze.

- Pantallonat : Kane dy xhepa anesor me prerje diagonale dhe nje xhep prapa (120 x 150 m/m), pa kapak, mberthehet me kopsë ebaniti. Kane nga dy pensa ne te dy anet. Zinxhir konfeksioni per mberthimin e pantallonave, me dhembe plastik. Kapse metalike mashkull - femer per mbylljen e pantallonave dhe bishtok. Qemer i pergatitur per pantallonat. Shtate vega per kalimin e rripit 50 mm te gjere.

-Kapele : Modeli-tip oficeri.

- Ka forme vezake.

- Materiali dhe ngjyra si e kostumit.

- Prodhohet ne dhjete numra (53 -f 62). Numuri perfaqeson perimetrin e kokes. Strehe plastike (te mos deformohet nga ndryshimi i temperatures se ajrit), me shkelqim nga siper, me gjeresi ne qender 50 mm, ne ngjyre te zeze, me astar.Nga brenda kapelja ka astar mendafshi, dhe rreth tepeleku (nga brenda) ka te qepur nje shirit lekure me gjeresi 5 cm. Per te ruajtur formen, nga brenda vendoset nje flete geliku 5 mm e gjere me fortesi deri 60 mangan. Mbi strehe vendoset nje shirit plastik i zi (per inspektoret ngjyre argjendi) me shkelqim, me gjeresi 15 m/m dhe mberthehet anash me dy kopsa te vogela metalike ne ngjyre argjendi. Ne balle vendoset sterna e Bashkise me permasa: 50 m/m gjatesi e 34 m/m gjeresi.

Legjenda:

A - lartesia e rrethit te kapeles sipas perimetrit te kokes

B - gjeresia e urave perpara.

C - gjeresia e urave prapa (shenim: urat perpara dhe prapa jane te perforcuara me fortese te kollaritur).

D - gjatesia e tepeleku te kapeles.

E - gjeresia e tepeleku te kapeles.

F - permasat e rrethit plastik ne tepelek

Garancia 2 vite

2.XHUP

Këto specifikime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të Xhupit sintetik të Policisë Bashkiake, të realizuar në linjë industriale, të ndërtuar me materialet e poshtëshënuara

Materialet që do të përdoren për prodhimin e Xhupit:

- Material sintetik, 100% poliester i veshur me polieteren, i papërshkueshëm nga uji, cilësi e parë, = 165 gr/m².
- Thurje garniturë.
- Veshje të ngrohtë : vatinë 120 ± 3gr /m².
- Astar i brendshëm 100 % rrjetë.
- Pesha për m² = 125 ± 5 gr.
- Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrave, nota 4 - 5 .
- Një xhep i brendshëm, që mberthehet me kopsë dhe dy xhepa përpara - poshtë, prerje vertikale .
- Mberthimi para me zinxhir konfeksioni me dhëmbë plastikë i qepur nën sallki.
- Qepje industriale, me penj blu 80/2; 100% poliester.
- Mëngët mberthehen me rrip me perçinë me sustë, po kështu dhe spaletat.
- Ngjyra blu e errët.
- Me kapuç fëshfëshe që mblidhet prapa jakës.

- *Fashë fosforeshente, ngjyrë argjendi me gjerësi 30 m/m në shpinë, gjoksin e djathtë dhe 20 m/m tek rripi i mëngëve.*
- *Në krahun e majtë anash, poshtë kokës së supit, qepet shiriti hark ku shkruhet "POLICIA BASHKIAKE" dhe nën të qepet Stema e Bashkisë Durrës.*
- *Gjithashtu në pjesë të prapme të xhupit të këtyre mbishkrimin Policia Bashkiake.*
- *Në gjoksin e djathtë mbi fashë qepet bazament velkrofi për numrin personal.*
- *Per inspektorët xhupi të këtyre gjatësi tërcerëshe, me kapuç fëshfëshe që mblihet prapa jakës.*

Garancia 2 vite

3.PANTALLONA VERORE

Keto specifikime përcaktojnë kërkesat çilesore për prodhimin e pantallonave të verës të Policisë Bashkiake me tekstil të zgjahur, ngjyre blu i erret, çilesi e pare.

Materialet që do të përdoren për prodhimin e pantallonave të verës:

- *Stof blu i erret, çilesi e pare, i tezgjahur me përzierje 35%viskoz dhe 65% poliestër ($\pm 3\%$).*
- *Pesha për m² : 210 ± 5 gr.*
- *Thurje = sarzh 2/1. - Frazeline (material ngjites).*
- *Numuri i fillit: në baze = 45/2 ± 3 ; në ind = 52/1 ± 3 .*
- *Dendësia për 10 cm: në baze = 340 ± 6 ; në ind = 265 ± 6 .*
- *Qendrueshmeria (kg): në baze = 153 - 6; në ind = 70-6.*
- *Viera e qendrueshmerisë së ngjyrave, nota 4 - 5 .*
- *Astar xhepi dhe qemeri, tekstil 100% viskoz.*
- *Penj qepje blu 80/2, 100% poliestër ; qepje industriale.*
- *Zinxhir plastik konfeksioni 22-[^]24cm, kapse metalike (femer-mashkull), bishtok për mberthimin e pantallonave.*
- *Perpara ka kater pensa (dy në pdo ane) me thellesi 12 deri 15 m/m.*
- *Me dy xhepa anesor me prerje diagonale, një xhep prapa -djathtas me permasa 120x150 m/m, mberthimi me kopse ebaniti të zeze me kater vrima.*
- *Qemer i përgatitur për pantallonat. Shtate vega me gjerësi 50 m/m për kalimin e rripit të pantallonave.*

Garancia 1 vit

4.PANTALLONA DIMERORE

Pantalloni për meshkuj është e realizuar sipas modelit klasik dhe është i përbërë sipas elementave që vijojnë :

- *Qemer*
- *Dy këmbë*
- *Katër xhepa*

Qemer

Përgjatë qemerit janë të vënë 6 kalime, lartësi 5 cm dhe gjerësi 12 mm, me dritë të brendshme prej 5 cm, të forcuara mjaftueshëm nga rripi dhe trari lart në pjesën e jashtme dhe poshtë në pjesën e brendshme dhe të bërë me pelhurë dopio.

Xhepa

Janë katër, dy model francez të vëna përpara dhe dy të pasme :

- Xhepat anësorë : janë të pjërrta, të cojnë në qepjen e rripit, të pozicionuara rreth 3 cm nga qepja e fiankeve në pjesën e lartë, ndërsa në pjesën e poshtme janë të futura në qepjen e fiankeve. Hapja, e gjërë rreth 19 cm, është e forcuar në qepjet e jashtme dhe tranin.
- Xhepat e pasëm : janë horizontale dhe me dopio filet të vëna 7 cm larg qepjes qëndrore, të largësisë të variueshme nga 13 në 14 nga baza e prerjes; në pjesën e poshtme të xhepit, dhe 1 cm larg nga fileti është e bërë një vrimë vertikale me pikë rreth 20 mm, xhepat e brendshëm janë të realizuar në pëlhurë silesia
- Janë përshtatur nga brenda me një fintë dhe një kundër fintë moster e të njëjtës pëlhurë të pantallonave

Pantallonit duhet t'i sigurohet perthyerja permanente me hekurosje përpara të ekuilibruar për temperaturë

Garancia 1 vit

5.KEMISHE ME MENGE TE SHKURTRA

Këto specifikime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të këmishave me mëngë të shkurtër për Policinë Bashkiake, me puclinë të tezgjahur, cilësi e parë, me përzierje 33% pambuk dhe 67% poliestër(± 3%).

Materialet që do të përdoren për prodhim:

- Pupilina është në ngjyrë dhe cilësi të njëjtë me puclinën e këmishëve me mëngë të gjatë, me ngjyre bojeqielli.
- Jaka e mbyllur me kollaritje.
- Spalinave dhe kapakeve të xhepave u vendoset frazeline.
- Gjatësia e menges për prerjen e parë është 250 m/m, me rritje nga 10(dhjetë) m/m për çdo prerje, gjerësia 230 m/m.
- Qepja të bëhet me penjë 100% poliestër në ngjyrën e këmishës me 25-30 shpime gjilpëre në 50 m/m gjatësi.
- Mëngët në fund kthehen nga brenda dhe tegeli nga buza 23 mm.
- Mëngët në fund kthehen nga brenda dhe tegeli nga buza 23 mm.
- Dy xhepa pllakë në gjoks, me përmasa: gjerësi x lartësi=140x160 m/m, me kapak.
- Kapakët e xhepave, spalinat dhe mengët (në bashkim me trupin) të kenë tegela nga jashtë me 3 – 4 hapa në 10 (dhjetë) m/m dhe me largësi nga buza 5 mm.
- Kopsa të vogëla me ngjyrën e tekstilit për mbërthimin përpara, xhepat dhe spaletat.
- Në krahun e majtë anash, poshtë kokës së supit, qepet shiriti hark ku shkruhet“POLICIA BASHKIAKE” shiriti në formë harku
- Ky shirit qepet 4-5 cm poshtë kokës së supit, simetrik me qepjen e spalinës. Poshtë shiritit 33 m/m qepet Stema e Bashkisë, simetrike me harkun e poshtëm.
- Per inspektoret kemisha me ngjyre të bardhe.
- Kopsa të vogëla me ngjyrën ari për mbërthimin përpara, xhepat dhe spaletat.

Garancia 1 vit

6.KËMISHË ME MËNGË TË GJATA

Këto specifikime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të këmishave të Policisë Bashkiake, me mëngë të gjata, me puçlinë të tezgjahur, cilësi e parë.

Materialet që do të përdoren për prodhimin e këmishave:

- Puçlinë cilësi e parë, bojeqielli, tekstil i tezgjahur, me përzjerje 33% pamb.dhe 67% poliest.(± 3%).
- Fortesë mansheti për mëngët me kollaritje të plotë.
- Prodhoen me jakë të mbyllur.
- Numurat e gjoksit 7, nga 44 ÷ 56 .
- Pesha : = 110 ± 3 gr. – Thurje garniturë.
- Numurat e jakës:36,37-38,39-40,41-42,43-44,45-46,47-48,49-50.
- Frazelinë me ngjitje për forcimin e spalines, kapakëve të xhepave.
- Në gjoks ka dy xhepa pllakë me muzhik, me kapak me përmasa 14x16 cm.
- Kopsa të vogëla me ngjyrën e tekstilit për mbërthimin përpara, xhepat dhe spaletat.
- Në krahun e majtë, poshtë kokës së supit qepet shiriti hark “POLICIA BASHKIAKE” dhe nën të qepet stema e bashkisë.
- Në gjoksin e djathtë, mbi qepjen e kapakut të xhepit, qepet bazament velkrofi 70x20 m/m për vendosjen e numrit personal.
- Per inspektoret kemisha me ngjyre te bardhe.
- Kopsa të vogëla me ngjyrën ari për mbërthimin përpara, xhepat dhe spaletat.

Garancia 1 vit

7.KRAVATË PËR UNIFORMË

Keto specifikime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të kravatave. Materialet që do të përdoren:

- Materiali cilësi e parë, pelhure sintetike, 100 % poliester.
- Ngjyra blu e erret.
- Gjatesia 500 ± 20 mm ;
- Gjeresia 45±5 m/m në fillim (koka) e 80±5 m/m në fund.
- Me astar mendafshi, importi,(blu i erret ose i zi),100% poliester. Frazeline për fortese nga brenda, e lidhur në formë koke dhe në fund të jete në formë trekëndeshi dybrinjeshem.
- Me llastik të gjere 15 m/m që kalon dhe fiksohet brenda kokës, dhe në të dy anet e llastikut qepet velkrofi për t'u mberthyer në qafe me gjatesi 40 deri 50 m/m.
- Pesha e pelhures sintetike 190 ± 5 gr/m2 .

Garancia 1 vit

8.KAPELE VERORE

Me strehe të gjate plastike e veshur me dokun e vet, me perforcim në kupe, me rrip prapa për rregullimin e gjeresise, në balle shkruar me qendrisje me penj të bardhe në formë harku "POLICIA BASHKIAKE" dhe poshtë qepet sterna e Bashkisë.

Garancia 1 vit

9.EMBLEMË KRAHU

Stema e bashkisë me thurje me emertim " Policia Bashkiake "

etiketa e krahut me permasa 9.5 me 6.5 cm e cila vendoset ne krahun e majte.

Garancia 1 vit

10.KEPUCE DIMERORE

Materialet që do të përdoren për prodhim :

- Faqe natyrale (vaqetë) cilësi e parë, kromato, tip “ U ”.
- Astar meshin dhije 0,9÷1,1m/m për të gjitha pjesët e brëndëshme. Lejohet me trashësi 0,7 ÷ 0,9 m/m në faqet e brëndëshme e të përparme .
- Taban soleti (lëkurë natyrale).
- Kamaretë çeliku e mbuluar me kartonfibër të presuar.
- Penj sintetik mbi 9 kg. nr. 40/3 – 30/3 për qepjen e syprinës.
- Mbyllja e syprinës me tegela dopio ose 4 copë butona për palë.
- Bombë termoplastike për pjesën e majës.
- Fortesë termoplastike ose karton i presuar i posaçëm për prapshinën.
- Fjapë gome të presuar me trashësi 2,8 ÷ 3.0 mm.
- Xhiro gome të presuar, trashësia 2,8 ÷ 3.0 mm.
- Shollë gome të presuar (nga poshtë me llokma të dhëmbëzuara). Trashësia pa llokma: 7÷8 mm, me llokma: 17 ÷ 18 mm.
- Taka e këpucës me llokmën, lartësia 25 ÷ 26 mm, ndërsa bashkë me hapsirën që shoqërohet me xhiron e gomës, lartësinë e takës do të jetë 32 ± 1 m/m.
- Penj sintetik fill 1 m/m me rezistencë 38 kg për qepjen e fjapës me tabanin.
- Ngjitës me një komponent për ngjitjen e fjapës me tabanin.
- Ngjitës me dy komponent për ngjitjen e fjapës me gomën (shollën).
- Me katër vrima me size në fillim në të dy anët e në vazhdim të vrimave gjashtë kapse në formë gonxhe ose fisash për kalimin e lidhsave në formë kordoni.
- Lartësia e qafës së këpucës 230 ± 2 m/m mbi xhiron e gomës. Në mbyllje te lartësisë midis kapses 8 dhe 9 deri tek kapsja e 10 (sa gjerësia e tyre) nga 20 m/m larg buzeve (vize ose gonxhe) vendoset sfungjer midis astarit dhe lekures dhe e qepur brenda jashte me penje sintetik.
- Semenca makine me gjatësi 8÷9 m/m për mbërthim të faqes së këpucës me tabanin në pjesën e prapme .
- Në lapetë mbi kurrizin e këmbës në gjerësinë 30 m/m dhe 40 m/m poshtë përfundimittë lapetës vendoset sfungjer midis astarit dhe lëkurës të qepur brenda jashtë me penj sintetik.

Karakteristikat fiziko – mekanike – kimike te lekureve natyrale (vaqete tip “u”) per kepuce me qafa trupe

- Trashësia	1.9 ÷ 2.5 mm
- Yndyra në %	8 ÷ 11 %
- Qëndrueshmëria e plasjes së faqes 10 Mpa (kg/mm ²)	1.6
- Rezistenca ndaj këputjes së faqes	2.0
- Qëndrueshmëria deri në këputje në %.	÷ 70
- Penetrimi i ujit, jo më pakë se:	240' (4 orë)

Sholle gome dhe fjapë gome te presuar:

- Fortësia (në gradë shores): Sholla 85 ± 3

Garancia 1 vit

11.KEPUCE VERORE

Këpucë gjysma, me lidhësa, të veshur nga brenda me lëkurë dhe tabani i jashtëm me gomë. Lëkura e sipërme me teknikë “diell refleks” e cila zvogëlon efektin ngrohës të këpucës nga nxehtësia e diellit. Kjo i mbanë këmbët dhe lëkurën e këpucës të freskët.

Kërkesat teknike dizenjo

- *Lëkura e sipërme me teknike “diell refleks” është ngjyrë e zezë, e ajrosshme dhe kundra ujit.*
- *Këpuca të jetë e paisur komplet me lëkurë të brendëshme.*
- *Veshja e brendëshme duhet të jetë e vulosur (e ngjeshur mirë) me lëkurën e sipërme. Kemi një lidhëse të plotë nga thembera e këpucës në pjesën e pasme në majë të saj.*
- *Lidhësja duhet të jetë rezistente kundër fërkimit dhe të ketë 4 vrima në një krah për këpucë.*
- *Këpuca duhet të ketë pjesën e përparme elastike prej 8 mm dhe pjesën e thmbrës elastike prej 12 mm më e pakta.*
- *Shtroja është e zëvendësueshme, të lahet në temperaturë 40⁰c, formë anatomike dhe kapacitet të lartë kundra lagështisë dhe shpejtësi tharje.*

Materiali

- *Lëkura e sipërme e këpucës.*
- *Ngjyra e zezë*

Hidratimi i lëkurës së jashtëme

- *Mbërthimi i thembrës*
- *Rezistente ndaj konsumit, garanci grisjeje, material jo i endur, ngjyrë të qëndrueshme dhe të lartë.*
- *Tabani i brendshëm prej shajaku, në pjesë të ngushtë të këpucës dhe lëkurë të drejtë.*
- *Lidhëse*
- *Lidhëset duhet të jenë material poliestër*

Filli

- *Peri duhet t jetë poliestër me dendësi të paktën 30/3 me veti qëndrueshmërie ndaj ujt.*
- *Ngjyra e zezë;*
- *Pjesa e poshtëme bëhet nga një gomë speciale me sipërfaqen e gomës dhe thembrës elegante, jashtëzakonisht rezistente ndaj rrëshqitjes, të pashënuar, antistatik, rezistent ndaj vajit dhe karburantit*

Garancia 1 vit

12.PULOVRA

Pulovra jake V eshte e perbere nga 50 % lesh dhe 50 % poliester. Eshte ne forme me jake V, modeli I thurjes 2 + 2. Me fortesa tek supet dhe ne bryla. Pulovra perbehet nga keto elemente :

- *Nje te perparme (gjoksi)*
- *Nje te pasme (shpina)*
- *Nje jake*
- *Dy minge te gjata*

E perparmja, e pasmja dhe menget perfundojne ne fund me bordure te gjere 6.5 cm me punim thurje llastik, Te gjitha keto pjese jane te bashkuara me njera tjetren per te formuar pulovren e plote duke u qepur me syzator ne ije, ne supe e ne minge. Jaka eshte e perbere nga nje cope e vetme e punuar ne modelin llastik.

Rekomandohet te lahet deri ne 40 grade celcius, te hekuroset me hekur te lehte, te mos lahet me zbardhues, te mos dergohet ne pastrim kimik per larje me te thate.

Permasat e qepjes vijojne nga masa XS dhe vazhdon me masat S, M, L, XL, 2XL, 3XL , duke perfunduar me masen 4XL .

Tregtimi i tyre behet i paketuar ne qese plastike individuale.

Garancia 1 vit

13.BLUZA ME MËNGË TË SHKURTRA

Materiali bazë qe duhet te perdoret per prodhimin e artikullit bluze me minge te shkurtra duhet te jete me keto te dhena teknike:

Ngjyra baze -bojeqielli .

Jaka dhe menget - blu e erret

Perberja -100% pambuk

Pesha- 230gr/m2

Qendrueshmeria e ngjyres nota 4-5

Qendrueshmeria e ngjyres ndaj drites nota 6

Qendrueshmeria ne ferkim mbi 10.000 cile

Ngjyrosja e tekstilit te jete Intathren

Materiale reflektive

Perberja 100% poliamid

Gjeresia 5cm

Ngjyra gri fluorishente

Kujdes: Shiriti duhet të perbehet nga lente retro -reflektive me kend te gjere qe ngjiten ne tekstil me temperature te larte.

*Materiali duhet ti rezistoje mbi 105 cikle larje ne temperaturen 60*C*

Ne pjesen e perparme te bluzes ne anen e djathte te gjoksit duhet te stampohet POLICIA BASHKIAKE .

Ne pjesen e pasme te bluzes ne shpine duhet te vendoset shkrimi POLICIA BASHKIAKE

Bluza duhet të ketë një velkrof në anën e majtë të krahut për ngjitjen e logos të bashkisë dhe një velkrof para të gjoksi majtas për nr e identifikimit.

Bluza e perfunduar duhet të paloset duke e vendosur njerën nga menget në brendesi dhe tjetra përpara .

Bluza e palosur duhet të futet në qese polietileni

Garancia 1 vit

14.RRIP OPERACIONAL

Këto specifikime teknike, përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të Rripit të shërbimit, sintetik për Policinë Bashkiake.

Ka mekanizëm të veçantë për rregullim të lehtë të gjatësisë edhe pse ekzistojnë madhësi të vecanta të rripit nga M deri të 2XL. Këto rripa janë specifike për punonjësit e policisë, sepse në to mund të vihet këllëf për pistoletë, rezerva municionesh, shkop , pranga ,radio dhe çdo gjë që ju duhet. Ka ngjyrë të zezë kështu që përshatet lehtë me uniformën ose pajisjen që ka veshur polici.

Materialet që do të përdoren:

- *Materiali tekstil – sintetik, cilësisë së parë, me thurje të dendur (nga tërheqja nuk zgjatohet).*
- *Astar velkrofi në gjysmën e gjatësisë fundore.*
- *Ngjyra : I zi.*
- *Gjatësia e përgjithëshme: 1350 (± 10 m / m).*
- *Gjerësia : 55 ÷ 60 m/m.*
- *Tokëza për mbërthim : femër – mashkull (metalike e kromuar ose plastike) në ngjyrë të zezë.*
- *Vega : dy copë të futura në rrip, me gjerësi 15 m/m, me material metalik i kromuar ose sintetik të thurur.*

Ripi të jetë i kompletuar me aksesorët:

- *Mbajtëse e bllokut të gjobave.*
- *Këllëf për mbajtjen e prangave (hekurave lidhës).*
- *Unazë për mbajtjen e shkopit të gomës.*
- *Mbajtëse e radios.*

Garancia 1 vit

15.SHIRITA SINJALIZUES

Shiriti sinjalizues, të këte dimensionet 7.5 cmx100 mx0.03 mmi cili përdoret në punime në rrugë për të kufizuar zonat e punës. Materiali përbërës është PVC me fushe të bardhe të këte të stampuar stemen e Bashkisë Durrës, mbishkrimin Policia Bashkiake dhe ndalim kalimi me ngjyre bojeqielli.

Garancia 1 vit

16.KOSTUM CEREMONIAL

Kostum stofë ceremoniale (Xhakete + 1 pale pantallona+kapele oficeri) Materiali stof teritali 280 gr/m² diagonal ngjyra blu erret, xhaketa ceremoniale me kater xhepa me kapak, me spaletat per vendosjen e gradave. Pantallonat prerje klasike me dy xhepa perpara dhe fileto xhep mbrapa me penca perpara dhe qemer klasik dhe fileta. Kapelia model oficeri e rrumbullaket dhe pak strehe.

RRIP MESI KRAHEQAFE LEKURE NATYRALE E BARDHE.

1. Këto specifikime teknike, përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të rripit të mesit kraheqafe.për Policinë Bashkiake, me lëkurë telatinë, cilësi e parë, me lekure natyrale (telatina)me regjie gjysem kromi e bardhe.

Materialet që do të përdoren për prodhimin e rripit :

Lekure natyrale (telatina)me regjie gjysem kromi,cilesia e pare, ngjyre e bardhe. Gjatesia : 1200 – 1350 mm.

Gjeresia : 47 mm(1 mm).

Trashesia e rrypit : 3.5 –4 mm ne te gjithë gjatesine .

Togez inoksi ne forme pllake me permasa 70 X 52 mm,me buze nga brenda 10mm .

Trashesia e inoksit 0.8 mm. Ka nje kunj nga poshte me koke per mberthim Rrypit ne pjesen fundore i hapen 10(dhjet) vrima ne vije te drejte, ne gjatesi me 25 mm larg njera-tjetres.

Kraheqafa perbehet nga dy pjese:

a. Pjesa e prapme ka gjatesine 800 – 1000 mm(15 mm);

b. Pjesa e perparme ka gjatesi 280 – 330 mm,

c. Togez inoksi katerkendeshe e hapur me permasa 33 X 28 mm dhe me nje grep per mberthim. Perçinat e mberthimit te jene inoksi. Gjeresia e rrypit 18mm, trashesia 2 mm.

KORDONI I CEREMONIALIT Punimi.

Litari është bërë nga një gershet i vetëm me gjatësi të barabartë me 8 m, endur ne menyre te dyfishtë për të nxjerre 2 shigjeta me gjatësi të barabartë përkatësisht me 70 cm dhe 55 cm te lidhura ndërmjet tyre së bashku me fije të qepur me dore 100% prej pambuku te duhur me vlerë të mjaftueshme për rezistencë. Laku kryesor (i cili do të përfundojë mbi supe, i quajtur “mbi kalim krahu”është i përbërë nga dy unaza secili me një diametër prej 25 cm, te marre nga i njëjti gershet siç përshkruhet më sipër, gjatë një para-përpunimi. Laku qe eshte i vendosur rreth pulles se supit dhe përbëhet nga nje kordon me të njëjtën ngjyrë si tubulari sa me siper pershkruar, dhe eshte qepur sipas pjeses se siperme te litarit te shkurte. Seciles prej dy skajeve i eshte vendosur nje maje prej bronzi. Nga nje distance prej perafersisht 15 cm nga maja te hollë është aplikuar një lak qe duhet te futet ne butonat e xhaketes.

Përbërja për litarin e shkurtër argjendi litar i: 80% poliestër i metalizuar (fije17/18000), 20% pambuk (emertimi 2 / 5000)

DOREZA TE BARDHA CEREMONIALI

Pambuk 100% .

Ngjyra e bardhe .

Penje qepje makine, ngjyre e bardhe, 100% pambuk.

Dorezat te jene te buta,pa njolla dhe ndryshime në ngjyrë.

Garancia 4 vjet

17.ATLETE UNIFORME

Të jenë me përbërje të kombinuar lëkure të ndërthur me rrjetë në masën 20-30%. Të kenë lidhëse të cilat kalojnë në vrima të përforcuara me tegela të rregullt me hap të njëjtë, pa grumbullime penjësh dhe me perçina. Këpucët (atletet), të jenë të përshtatshme për vrapim në terrene të hapura, pjesa që prek tokën të jetë prej gome të butë, ku të jetë stampuar dukshëm numri. Tabani nga brenda të jetë i trashë dhe poroz. Atletet të jenë ngjyra të ndryshme, të cilat do të përcaktohen në momentin e lidhjes së kontratës. Të paketohen në kuti kartoni të shkruara të dhënat, sipas kërkesave të mësipërme. Numri i këpucës duhet të jetë i dallueshëm.

Garancia 1 vit

18.ELEKTIK I THJESHTE DORE

Elektriku i dorës një aksesori i domozdoshëm për tu orientuar në errësi.

- Tipi : Elektrik dore
- Fluksi i ndriçimit : 110 lm
- Lloji i llambave : LED
- Gjatësia max : 125/250m rreze shikimi
- Shkalla e mbrojtjes : IP44
- Përmasat : H24.6 cm

Garancia 1 vit

19. JELEK FOSFORISHENT

Materiali që do të përdoret në prodhimin e jelekut fosforishent :

Materiali poliester i veshur me polieteren që ka vetëpërshkrushmëri natën.

Shirita fosforishent me diametër 5 cm vendosur në pjesën e parme dhe pasme. Pjesa e sipërme e jelekut të jete ngjyre jeshile fosfor ndersa pjesa e poshtme ngjyre blu e erret. Mberthimi para me zinxhir konfeksioni me dhëmbë plastikë i qepur nën sallki. Në pjesën e perparme të jelekut të jete të vendosur dy xhepa pllake me kapak dhe larte me mbishkrim Policia Bashkiake.

Stampuar në shpine stema e Bashkisë Durrës me mbishkrim POLICIA BASHKIAKE.

Garancia 1 vit

20.XHUP FOSFORESHENT OPERACIONAL - KUNDRA SHIUT

- Këto specifikime teknike përcaktojnë kërkesat cilësore të prodhimit të Xhupit sintetik të policisë bashkiake.
- Realizohet në linjë industriale, në mbështetje të pamjes së jashtme të mostrës fizike (1 xhup, numur gjoksi 52, gjatësi trupore 170 ÷ 172 cm, prerja III), të ndërthuar me materialet e poshtëshënuara, të shoqëruara me nga një pjesë 0,3 ml gjatësi lëndë e parë (tekstil impermeable i gomuar) dhe sa gjerësia e tekstit. Të dy anët e tekstit të jenë të mbyllura në anë (format të rregullt).

❖ Materialet që do të përdoren për prodhimin e Xhupit:

- *Material sintetik, 100% poliamid, i papërshkueshëm nga uji, cilësi e parë.*
 - a. *Pesha e materialit poliamid = 165 gr / m².*
 - b. *Dy shtresa gomimi e dy shtresa akriliku.*
 - c. *Thurje garniturë.*
- *Poshtë astarit vendoset vatinë = 120 ± 5 gr / m².*
- *Astar mëndafshi importi (blu i errët ose i zi), 100 % poliestër, qepur në formë rombi.*
- *Pesha e astarit për m² = 125 ± 5 gr.*
- *Numuri i fijeve si në bazë e ind (për 10 cm) do të jetë 340 ± 10 fije .*
- *Qëndrueshmëria (kg) në bazë = 95 ± 5; ndërsa në ind = 90 ± 5.*
- *Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrave, nota 4 - 5 .*
- *Një xhep në gjoksin e majtë, i brendshëm, me kapak nga jashtë që mbërthehet me perçinë, një xhep i brendshëm në anën e djathtë që mbërthehet me kopsë ebaniti dhe dy xhepa përpara – poshtë me prerje diagonale.*
- *Mbërthimi para i xhupit, me zinxhir konfeksioni me dhëmbë plastikë dhe 3 perçina (me sustë).*
- *Qepje industriale, me penj blu 80/2; 100% poliestër.*
- *Mëngët, tek dora kanë llastik, por dhe rrip që mbërthehet me perçinë, po kështu mbërthehen dhe spaletat.*
- *Ngjyra jeshile fosfor. Me kapuç fëshfëshe që mblidhet prapa jakës.*
- *Fashë fosforeshente, ngjyrë argjendi me gjerësi 30 m/m në shpinë, gjoksin e djathtë dhe 20 m/m tek rripi i mëngëve.*
- *Prodhoet në përmasat: S; M; L; XL; XXL; XXXL .*
- *Gjatësia për madhësinë XL = 86 cm.*
- *Në krahun e majtë anash, poshtë kokës së supit, qepet shiriti hark ku shkruhet me qëndisje me penj të bardhë “ POLICIA BASHKIAKE ” dhe nën të qepet Stema e Bashkisë.*
- *Në gjoksin e djathtë mbi fashë qepet bazament velkrofi për numurin personal.*

Garancia 1 vit

21.NUMER IDENTIFIKIMI

Numri i identifikimit është i personalizuar për çdo punonjës të Policisë Bashkiake. Bazamenti i tij është në formë drejtkëndore, me përmasa 86 mm x 30 mm. Në pjesën e sipërme të tij duhet të vendosen elementët:

- *1 (një) kornizë e kuqe, plastike në formë drejtkëndore (2.5 – 3) mm*
- Stema e Bashkisë Durrës e qendisur me penj ne fushe bojeqielli.*
- Numri identifikimit te filloj me numrin rendor 001 dhe te perfundoje me nr 080.*

Garancia 1 vit

22.PANTALLONA TE SHKURTRA

Pantalloni për meshkuj është e realizuar sipas modelit klasik dhe është i përbërë sipas elementave që vijojnë :

- *Qemer*
- *Dy këmbë*
- *Gjashte xhepa*

Qemer

Përgjatë qemerit janë të vëna 6 kalime, lartësi 5 cm dhe gjerësi 12 mm, me dritë të brendshme prej 5 cm, të forcuara mjaftueshëm nga rripi dhe trari lart në pjesën e jashtme dhe poshtë në pjesën e brendshme dhe të bërë me pelhurë dopio.

Xhepa

Janë gjashte, dy model francez të vëna përpara dhe dy të pasme dhe dy ne forme pllake me kapak ne pjesen e kone pjesen anesore mbi gju:

- Xhepat anësorë : janë të pjërrta, të cojnë në qepjen e rripit, të pozicionuara rreth 3 cm nga qepja e fiankeve në pjesën e lartë, ndërsa në pjesën e poshtme janë të futura në qepjen e fiankeve. Hapja, e gjërë rrerh 19 cm, është e forcuar në qepjet e jashtme dhe tranin.
- Xhepat e pasëm : janë horizontale dhe me dopio filet të vëna 7 cm larg qepjes qëndrore, të largësisë të variueshme nga 13 në 14 nga baza e prerjes; në pjesën e poshtme të xhepit, dhe 1 cm larg nga fileti është e bërë një vrimë vertikale me pikë rreth 20 mm, xhepat e brendshem janë të realizuar në pelhurë Silesia.
- Xhepat mbi gjurin anesor ne forme pllake me kapak me nje vrime vertikale pikë rreth 20 mm e cila mberthet me nje kopse plastike .
- Janë përshtatur nga brenda me një fintë dhe një kundër fintë moster e të njëjtës pelhurë të pantallonave

Garancia 1 vit

23.EMBLEMË KAPELE

Stema e bashkise me thurrje me emertim” Policia Bashkiake”
Etiketa e kapeles me permasa 5 cm me 3 cm.

24.PRANGA

Hekurat lidhëse (prangat) të jenë manovrueshme për përdorim të shpejtë, të jenë te pajisura me dy çelësa bllokimi, te sigurohen me bllokues te dyfishte, dhe forca e hapjes të jetë 200 kg. Hekurat lidhes (prangat) të jenë të pajisura me këllëf me ngjyrë të zezë me mbajtëse per tu vendosur në rrip.

Përmasat

1. Gjatësia e përgjithëshme..... 190 deri 200 mm
2. Trashësia e fletes dyfishe 2 + 05 mm
3. Trashësia e fletes me dhëmbëza..... 4 + 05 mm
4. Pesha..... 330+ 10 gr.
5. Perimetri min. i zones se shterngimit... 160 + 5 mm
6. Perimetri max. i zones se shterngimit... 200 + 5 mm

Materiali

1. Çelik me ngjyrë metalizato

Masat e sigurimit

1. Prangat të sigurohet me çelës
2. Pranga te jete e pajisur me siguresë te dyfishte bllokimi

3. Forca e hapjes 200kg
4. Prangat te jene te pajisura me dy kopje celesi
5. Tipi i bashkimit me menteshe

Mbajtëse prangash

1. Ngjyra.....E zezë
2. Të jetë e pajisur me mbajtëse për tu vendosur në rrip.

25.SHKOPINJ GOME

Jane te perbere nga gome e presuar me diameter 3 cm. Gjatesia e shkopit te gomes eshte 59.5 cm. Larg nga njera ane e shkopit per 43.5 cm dhe nga ana tjeter e shkopit per 16 cm (ne aks) eshte doreza me te njejtin diameter me gjatesi 14 cm. Doreza ne maje, ka nje koke me diameter 5 cm ne forme sferike.

26.DRYN

Te jete prodhuar nga nje material shume rezistent me celik te trajtuar ne disa etapa per ta bere shume te qendrueshem ndaj kushteve klimaterike.

Me permasa 40mmx35mm me bosht të lëvizshëm. Me 3 kopje çelsash.

- Ngjyra : Bronze
- Njesia : PC
- Materiali : Çelik/bronz

Garancia 1 vit

27.TABELA SINJALIZUESE

Te jete e ndertuar prej materiali plastik te bardhe me mbishkrimin Policia Bashkiake.

Me permasa : gjatesia 44 cm me diameter 15.5 cm.

Garancia 1 vit

28. BILBIL

Te jete i ndertuar nga metal i nje cilësie të lartë, me rrip përbërë nga material nailoni. Te kete nje tingull të lartë e të përshtatshëm per tu degjuar dhe orientuar mjetet ne trafik.

Garancia 1 vit

Afatit i dorëzimit të mallit 30 ditë.

Grupi i Specifikimeve Teknike

III.1.5 Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 3, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme

për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor në lidhje me plotësimin e kriterit më sipër ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të parqesin certifikate konformiteti produkti për artikujt XHUP sipas standardeve •SSH/ EN 343:2019; •SSH/ EN ISO 20471:2013 ;•SSH/ EN ISO 13688:2013 •SSH/ EN 342:2017. Sa më lart, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Malbertex” SHPK për përmbushjen e kriterit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën III.1.2 të këtij vendimi. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Malbertex” SHPK lidhur me mospërmbushjen nga ana e këtij të fundit të kriterit për certifikatën e konformitetit, nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ai për përmbushjen e këtij kriteri, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik “Malbertex” SHPK ka plotësuar kriterin e mësipërm të vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit, pasi nga verifikimi i përmbajtjes së dokumentit deklaratë Konformiteti të ngarkuar nga operatori ekonomik ankimues në sistem në gjuhën angleze me vërtetim njësie me origjinalin, si dhe të përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe, rezulton se nga deklaratimet e kryera nga Cerva Group a.s në këtë dokument, ajo shfaqet në cilësinë e prodhuesit dhe ka cituar të gjitha standardet e kërkuara. Në këtë kuptim KPP gjykon, se kompania “Malbertex” SHPK ne përmbushje të kriterit të vendosur nga AK i ndryshuar me shtojcën e publikuar, ka ngarkuar në SPE dokumentacionin në përputhje me kërkesat e AK.

Në këtë kuadër Komisioni gjykon, se me dokumentacionin e paraqitur operatori ekonomik ankimues “Malbertex” SHPK e përmbush kriterin e mësipërm.

Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe

funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Malbertex” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-72698-06-15-2023, me objekt: “Blerje uniforma për Policinë Bashkiake” me fond limit 6,833,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 30.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO për skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Malbertex” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri